



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 354/3 Prot.

Tiranë, më 12.03.2025

V E N D I M

Nr. 56, Datë 12.03.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 48, datë 25.02.2025, e paraqitur nga znj. T.Ç kundër Zyrës Përmbarimore “E.M” Shkodër, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “moshës”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi në mes të tjerash informon se: “Jam pensioniste dhe jam përballur me një situatë diskriminuuese në zyrën përmbarimore “E.M”, ku u detyrova të shkoja për të zbatuar Vendimin nr. 1331, datë 31.05.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, të lënë në fuqi me Vendimin nr. 313, datë 21.06.2012 të Gjykatës së Apelit Shkodër, për pjesën e takuar të pensionit të bashkëshortit të ndjerë.

Dokumentet e çështjes i dorëzova tek Përmbaruese E.M, e cila më kërkoi ti lëshoja një dëshmi autorizimi për të zbatuar pikat e vendimit të gjykatës dhe të paguaja një mandat 5.000 lekë dhe një mandat tjetër 6.000 lekë në Bankën Raiffeisen, të cilat i pagova. Më pas kam shkuar disa herë për të pyetur për ekzekutimin e vendimit, por znj. M më thoshte hajde pas dy javësh. Duke parë që çështja nuk po zgjidhej, shkova përsëri tek zyra e përmbarueses për të tërhequr dokumentet. Përmbaruesja më tha që e kishte ekzekutuar vendimin e gjykatës dhe lekët i kishte gati. I kërkova që të më jepte lekët që më takonin dhe znj. M më tha që të shkoja përsëri ditën tjetër për ti marrë ato (kjo ngjarje ka ndodhur në datë 3-4 dhjetor 2012). Kam shkuar disa herë në zyrën e përmbarueses, por ajo nuk ishte në zyrë, derisa me datë 21.12.2012 e takova dhe i kërkova lekët.

Kur hyra në zyrë, znj. M urdhëroi punonjësen e zyrës që të shkruante ato që do thoshte ajo, që është zbatuar çdo procedurë në bazë të vendimit të gjykatës dhe ligjit të përndjekurve politikë.

Më pas më urdhëroi që të firmosja një dokument, por unë nuk pranova derisa të merrja lekët sipas pikës tre të vendimit të gjykatës. Pas disa tentativave për shumën që do merrja, unë pranova të gjitha lekët që më ofroi në total (48.700 lekë) për shkak të gjendjes time ekonomike të rëndë.

Për procesverbalin, i thashë që do ta firmosja pasi ta kisha lexuar përmbajtjen e plotë të këtij dokumenti dhe shtriva dorën që ta merrja. Reagimi i znj. M në ato momente ishte shumë i ashpër. Ajo mori fletën e procesverbalit dhe e grisi para syve të mi. Unë e pyeta për arsyen e veprimit të saj dhe ajo më tha me tone të ashpra që duhet ta firmosja patjetër dokumentin, duke qenë se kisha marrë lekët dhe më nxori përjashta. Pas kësaj përgatita një vërtetim nga ana ime që konfirmonte marrjen e lekëve nga zyra e “E.M” në datën 21.12.2012.

Në datë 09.01.2013 shkova që të tërhiqja dokumentet e mia dhe të firmosja dokumentin për marrjen e lekëve. Deri në këtë datë nuk kisha asnjë dijeni për veprimet e kryera nga ajo në mënyrë të fshehtë. Pas marrjes së firmës time, i kërkova fletën që firmosa unë dhe ajo, që ta kisha si dokument. Ajo më tha që nuk mund ta jap këtë dokument sepse është i zyrës time dhe nuk lejohet që të nxirret jashtë zyrës. Pas kësaj znj. M u ngrit në këmbë dhe vuri dy duart në kokën e saj duke thënë “obobo çfarë bëra me mundin edhe me djersën që është derdhur në burgun e Burrelit”. Unë e korrigjova në ato momente duke i thënë që burri im kishte qenë në minierën e Spaçit të Mirditës, duke menduar nga ana ime që ajo i tha këto fjalë me kuptimin që ajo kishte zvarritur çështjen dhe nuk kishte kryer punë. Më pas i thashë që do të shkoja në një zyrë tjetër përmbarimore për të ekzekutuar vendimin e gjykatës. Më pas u paraqita tek përmbaruesi shtetëror. Ai më kërkoi dokumentin që firmosa unë dhe përmbaruesja E.M në datë 09.01.2013, si dhe dokumentin që vërteton që E.M kishte kryer disa veprime në lidhje me vendimin e gjykatës. Kur shkova të merrja dokumentin ajo më dha një dokument me 19 faqe dhe ishte hera e parë që e kisha parë (kjo ngjarje ka ndodhur në datë 10.01.2013). Në dy faqet e fundit të këtij dokumenti kishte shkruar që vendimi i gjykatës është ekzekutuar tërësisht dhe për këtë arsye kishte vendosur pushimin e vendimit të ekzekutimit të datës 12.09.2012 me datën 28.12.2012. Qëllimi i gjithë asaj ishte që ajo të zbatonte vendimin tërësisht dhe jo pjesërisht, por ajo e zbatoi vendimin pjesërisht dhe te dokumenti shkroi që e kishte zbatuar tërësisht. Të gjitha këto veprime janë bërë në mënyrë të fshehtë pa dijeninë time. Sot e kësaj dite nuk kam mundur që të vë znj. E.M përpara përgjegjësisë për veprimet që bëri mbrapa krahëve të mi”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet *ndaj çdo veprimi apo mosveprimi* të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët *publikë apo privatë*, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, konstatohet se:

Në ankesën objekt shqyrtimi znj. T.Ç, pretendon se diskriminohet nga Zyra Përmbartimore “E.M”, për shkak të moshës.

Në nenin 33, pika 4, gërma dh), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet se: “Ankesa nuk pranohet kur: (2) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese”. Parashikimi i sipërcituar nuk është kumulativ dhe kërkon si kriter për mospranimin e ankesës, plotësimin e njërit prej kushteve të mësipërme.

Referuar informacionit të cituar në ankesë dhe materialeve bashkëngjitur saj, rezulton se:

- Gjykata e Apelit Shkodër me Vendimin nr. 313, datë 21.06.2012, ka lënë në fuqi Vendimin nr. 1331, datë 31.05.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, lidhur me detyrimin e DRSSH Shkodër për ti paguar trashëgimtarëve të të ndjerit Gj.Ç diferencën e pensionit të papaguar dhe njohjen e qënies si minator nëntokë në minierën e Spaçit gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, për të ndjerin Gj.Ç, duke llogaritur efektet financiare për pensionin e familjarëve të Gj.Ç.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me Vendimin nr. 3635, datë 11.09.2012, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për Vendimin nr. 1331, datë 31.05.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

- Zyra Përmbartimore “E.M” me Vendimin nr. 102/Dkp, datë 28.12.2012, ka vendosur pushimin e ekzekutimit të “Urdhrit të Ekzekutimit” nr. 3635, datë 11.09.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi vendimi është ekzekutuar tërësisht dhe debitori ka plotësuar detyrimin ndaj kreditorit dhe ka paguar shumën 48.000 lekë, detyrim ndaj kreditorit. Për këtë vendim ankuesja ka marrë dijeni në datë 11.01.2013.

Referuar informacionit të cituar në ankesë rezulton se data e ndodhjes së diskriminimit të pretenduar është periudha dhjetor 2012, fakt i cili është pohuar dhe nga vetë ankuesja. Ndërkohë që, edhe data e konstatimit të diskriminimit nga ana e ankueses është data 11.01.2013, datë të cilën ankuesja e citon se ka marrë dijeni për pushimin e urdhrin të ekzekutimit, pasi vendimi ishte ekzekutuar tërësisht.

Për sa më sipër, KMD gjykon se momenti i ndodhjes së diskriminimit të pretenduar është periudha gjatë muajit dhjetor 2012, kur ankuesja i është drejtuar Zyrës Përmbartimore “E.M” Shkodër për ekzekutimin e vendimit të gjykatës. Edhe momenti i marrjes dijeni nga ankuesja mbi sjelljen diskriminuese të pretenduar nga Zyra Përmbartimore “E.M” Shkodër është data 11.01.2013. Ndërkohë që, data e depozitimit të ankesës pranë KMD-së është 25.02.2025. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se momenti i ndodhjes së diskriminimit daton më shumë se 3 (vjet) nga ndodhja e diskriminimit të pretenduar. Njëkohësisht, edhe momenti, i marrjes dijeni mbi diskriminimin e pretenduar, daton më vonë se 2 (dy) vjet nga data e depozitimit të ankesës nr. 48, datë 25.02.2025 pranë KMD-së.

Pra, konkludojmë se janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “dh” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 48, datë 25.02.2025, të paraqitur nga znj. T.Ç kundër Zyrës Përmbartimore “E.M” Shkodër, pasi është paraqitur tej afateve ligjore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

¹ Për analogji shih vendimet nr. 167, datë 23.08.2023 dhe nr. 158, datë 28.05.2024 të Komisionerit.